

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

LIGJET DHE TATIMET NË
KOSOVË

P4

ZGJIDHJET

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 11.07.2026

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	- <u>Kujdes!</u> Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga <u>ShKCAK-</u> PIKËT E DHËNA
1. Pjesa A	30	
2. Pjesa B	30	
3. Problemi 1	10	
4. Problemi 2	10	
5. Problemi 3	5	
6. Problemi 4	10	
7. Problemi 5	5	
Total	100	

Pjesa A - 30 pyetje (1 pikë secila - 30 pikë)-----NJË përgjigje të saktë

Tatimet: TVSH, TAK, TAP, kontributet dhe tatimet në burim

1. Në një analizë të qarkullimit për TVSH, cili element është më i saktë për pragun e regjistrimit të detyrueshëm?

- a) Regjistrimi kërkohet vetëm nëse fitimi neto kalon 30,000 euro
- b) Regjistrimi kërkohet kur qarkullimi tejkalon pragun ligjor prej 30,000 euro**
- c) Eksportet nuk merren asnjëherë në konsideratë në qarkullim
- d) Regjistrimi është gjithmonë vullnetar

2. Cila është norma standarde e TVSH-së në Kosovë?

- a) 16%
- b) 18%**
- c) 20%
- d) 8%

3. Cila është norma e reduktuar e TVSH-së?

- a) 5%
- b) 6%
- c) 8%**
- d) 10%

4. Furnizimi i mallrave për eksport, kur plotësohen kushtet dokumentare, zakonisht trajtohet si:

- a) Furnizim i përjashtuar pa të drejtë zbritjeje
- b) Furnizim me normë zero me të drejtë zbritjeje**
- c) Furnizim jashtë sistemit të TVSH-së pa të drejtë kreditimi
- d) Furnizim me normë standarde 18%

5. Nëse një shoqëri kosovare pranon shërbim konsulence nga një jo-rezident, parimi i ngarkesës së kundërt nënkupton që:

- a) Jo-rezidenti e deklaron TVSH-në në Kosovë në çdo rast
- b) Pranuesi vendor deklaron TVSH-në e llogaritur dhe, nëse ka të drejtë, TVSH-në e zbritshme**
- c) Transaksioni nuk regjistrohet në deklaratën e TVSH-së
- d) TVSH-ja paguhet vetëm në doganë

6. Baza e TVSH-së në import përfshin më saktë:

- a) Vetëm çmimin e faturës së furnitorit
- b) Vlerën doganore/CIF, doganën, akcizën nëse ka dhe ngarkesat e tjera të përfshira sipas ligjit**
- c) Vetëm transportin ndërkombëtar
- d) Vetëm fitimin e importuesit

7. Norma e Tatimit në të Ardhurat e Korporatave mbi të ardhurat e tatueshme është:

- a) 8%
- b) 9%
- c) 10%**
- d) 12%

8. Humbjet tatimore të korporatës mund të barten për një periudhë deri në:

- a) 4 vite
- b) 6 vite
- c) 8 vite
- d) 10 vite

9. Për qëllime të TAK, donacionet e pranueshme për organizata të licencuara zbriten deri në:

- a) 5% të fitimit pas tatimit
- b) 7% të të ardhurave bruto
- c) 10% të të ardhurave të tatueshme para zbritjes së donacionit
- d) Pa kufizim nëse pagesa është bankare

10. Krediti tatimor për sponsorizim të aktiviteteve të lejuara nuk mund të tejkalojë:

- a) 10% të qarkullimit
- b) 20% të fitimit bruto
- c) 30% të obligimit të TAK
- d) 50% të TVSH-së së pagueshme

11. Pagesa e shërbimeve profesionale ndaj një jo-rezidenti me aktivitete të përkoheshme në Kosovë, kur nuk zbatohet marrëveshje tjetër tatimore, zakonisht kërkon mbajtje në burim me normë:

- a) 5%
- b) 10%
- c) 15%
- d) 18%

12. Normat e zhvlerësimit tatimor sipas kategorive kryesore janë:

- a) Kategoria I 10%, Kategoria II 20%, Kategoria III 5%
- b) Kategoria I 5%, Kategoria II 20%, Kategoria III 10%
- c) Kategoria I 20%, Kategoria II 10%, Kategoria III 5%
- d) Të gjitha kategoritë 10%

13. Për llogaritjen e TAP-it në paga, baza më e drejtë tatimore është:

- a) Paga bruto pa asnjë zbritje
- b) Paga bruto pas kontributit pensional të punëmarrësit
- c) Paga neto pas TAP-it
- d) Vetëm paga bazë pa bonuse

Ligji për Shoqëritë Tregtare

14. Në një Shoqëri Aksionare, aksioni përfaqëson:

- a) Detyrim personal të aksionarit për borxhet e shoqërisë
- b) Njësi në bazë të së cilës ndahen interesat pronësore në shoqëri
- c) Kontratë punësimi me shoqërinë
- d) Licencë tregtare të shoqërisë

15. Aksionet e certifikuara dhe të pa-certifikuara të së njëjtës kategori kanë:

- a) Të drejta të ndryshme sipas mënyrës së evidencimit
- b) Të drejta identike, për aq sa janë të të njëjtit lloj/kategori
- c) Vetëm të drejtë dividendi por jo vote
- d) Vetëm të drejtë vote por jo dividendi

16. Parimi i përgjegjësisë së kufizuar të aksionarit në Sh.A. nënkupton se:

- a) Aksionari përgjigjet gjithmonë me pasurinë personale
- b) Aksionari nuk përgjigjet vetëm pse është aksionar, përveç rasteve të abuzimit/mashtrimit
- c) Drejtori përgjigjet për çdo borxh tregtar
- d) Shoqëria nuk përgjigjet me asetet e veta

17. Kur një drejtor ka interes personal në një transaksion të shoqërisë, qasja më e drejtë e qeverisjes është:

- a) Mosdeklarimi nëse transaksioni është fitimprurës
- b) Deklarimi i konfliktit, miratimi sipas rregullave dhe dokumentimi i vendimit
- c) Nënshkrimi i kontratës pa vendim organi
- d) Transferimi i transaksionit në emër personal

Ligji i Punës

18. Pushimi vjetor minimal sipas ligjit është:

- a) Dy javë
- b) Tri javë
- c) Së paku katër javë
- d) Saktësisht 30 ditë për çdo punonjës

19. Shtesa e pushimit vjetor sipas përvojës së punës është:

- a) Një ditë për çdo tre vite
- b) Një ditë për çdo pesë vite
- c) Dy ditë për çdo vit
- d) Vetëm pas 20 viteve

20. Periudha provuese për punonjësin e ri nuk mund të jetë më e gjatë se:

- a) 3 muaj
- b) 4 muaj
- c) 6 muaj
- d) 12 muaj

21. Për punë jashtë orarit, kompensimi minimal ligjor është së paku:

- a) +15%
- b) +20%
- c) +30%
- d) +50%

Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat

22. Afati i zakonshëm brenda të cilit ATK mund të kontrollojë/vlerësojë deklaratën tatimore është:

- a) 3 vite
- b) 4 vite
- c) 6 vite
- d) 10 vite

23. Regjistrat dhe dokumentacioni tatimor duhet të ruhen së paku:

- a) 3 vite
- b) 5 vite
- c) 6 vite**
- d) Vetëm deri në dorëzimin e deklaratës

24. Nëse personi përgjegjës me dashje nuk mban ose nuk paguan tatim të mbajtur në burim/kontribute, pasoja më e saktë është:

- a) Nuk ka përgjegjësi personale
- b) Mund të ketë përgjegjësi personale për shumën e papaguar**
- c) Përgjegjësia bie vetëm mbi kontabilistin e jashtëm
- d) Detyrimi fshihet në fund të vitit

25. Interesi për pagesat e vonuara tatimore llogaritet zakonisht në baza mujore me normë:

- a) 0.35%
- b) 0.50%
- c) 0.65%**
- d) 1.00%

26. Afati praktik për kundërshtim/ankesë ndaj një vlerësimi tatimor, nga pranimi i vendimit, është:

- a) 7 ditë
- b) 15 ditë
- c) 30 ditë**
- d) 90 ditë

Ligji për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim

27. Një mikro-ndërmarrje klasifikohet duke marrë parasysh, ndër të tjera:

- a) Vetëm numrin e pronarëve
- b) Pasqyrën e pozitës financiare, qarkullimin neto dhe numrin mesatar të punonjësve
- c) Vetëm fitimin e vitit
- d) Vetëm kapitalin themeltar

28. Një ndërmarrje konsiderohet e madhe kur tejkalon të paktën dy nga kriteret kryesore ligjore, përfshirë:

- a) Asetet 20 milion euro, qarkullimin 40 milion euro dhe 250 punonjës
- b) Asetet 350 mijë euro, qarkullimin 700 mijë euro dhe 10 punonjës
- c) Asetet 1 milion euro dhe qarkullimin 2 milion euro
- d) Vetëm kur është Sh.A.

29. Auditimi ligjor bëhet i detyrueshëm, ndër të tjera, kur shoqëria tregtare tejkalon qarkullimin neto vjetor prej:

- a) 200,000 euro
- b) 500,000 euro
- c) 1,000,000 euro
- d) 4,000,000 euro

30. Entitetet me interes publik përfshijnë në mënyrë tipike:

- a) Çdo SH.P.K. me më shumë se dy pronarë
- b) Institucionet financiare, siguruesit dhe entitetet e tjera të përcaktuara me ligj
- c) Vetëm bizneset familjare
- d) Vetëm ndërmarrjet mikro

Pjesa B - 3 studime rasti me pyetje objektive (30 pikë)----- NJË përgjigje të saktë

Secili rast ka 5 pyetje objektive. Çdo pyetje vlerësohet me 2 pikë.

Rasti 1: CloudBridge L.L.C. - shërbime digjitale dhe transaksione ndërkufitare (10 pikë)

CloudBridge L.L.C. ofron shërbime IT dhe licenca softuerike. Vlerat janë pa TVSH, përveç rasteve kur thuhet ndryshe.

- Shërbime IT vendore me normë standarde: 520,000 euro;
- Trajnime profesionale vendore me normë standarde: 40,000 euro;
- Shërbime SaaS për klientë biznesi në BE, të trajtuara si eksport/shërbim ndaj jo-rezidentit me të drejtë zbritjeje: 180,000 euro;
- Licencë cloud nga Irlandë: 60,000 euro;
- Blerje pajisjesh nga furnitor vendor: 141,600 euro me TVSH 18%;
- Blerje veture për menaxhment: 35,400 euro me TVSH 18%, përdorimi biznesor i dokumentuar 50%;
- Honorare konsulence për ekspert jo-rezident: 25,000 euro;
- Shpenzime të tjera të zbritshme: 300,000 euro; zhvlerësim tatimor: 28,000 euro;
- Donacion për OJQ të licencuar: 20,000 euro; sponsorizim sportiv i lejuar: 12,000 euro.

1. TVSH e llogaritur për furnizimet vendore është:

- a) 93,600 euro
- b) 100,800 euro**
- c) 126,000 euro
- d) 0 euro

2. TVSH e llogaritur me ngarkesë të kundërt për licencën cloud është:

- a) 9,600 euro
- b) 10,800 euro**
- c) 6,000 euro
- d) 0 euro

3. TVSH e zbritshme nga pajisjet vendore dhe licenca cloud, duke mos pranuar TVSH-në e veturës, është:

- a) 21,600 euro
- b) 32,400 euro**
- c) 38,400 euro
- d) 27,000 euro

4. Tatimi në burim për honorarin e jo-rezidentit është:

- a) 1,250 euro
- b) 2,500 euro**
- c) 4,500 euro
- d) 0 euro

5. TAK për pagesë pas kreditit të sponsorizimit është më afër:

- a) 18,700 euro
- b) 21,490 euro**
- c) 30,700 euro
- d) 24,560 euro

Rasti 2: AgroPack L.L.C. - prodhim, import dhe koeficient i zbritjes (10 pikë)

AgroPack prodhon produkte ushqimore dhe shërbime paketimi. Vlerat janë pa TVSH, përveç rasteve kur thuhet ndryshe. Koeficienti i zbritjes për shpenzime të përziera është 92%.

- Shitje produkte ushqimore me normë të reduktuar: 620,000 euro;
- Shitje shërbime paketimi me normë standarde: 210,000 euro;
- Të ardhura nga interesi bankar: 15,000 euro;
- Import lëndë të parë: CIF 220,000 euro; doganë 20,000 euro; akcizë 0 euro;
- Blerje vendore lëndë të parë: 354,000 euro me TVSH 18%;
- Blerje makineri prodhimi: 177,000 euro me TVSH 18%;
- Shpenzime administrative të përziera: 70,800 euro me TVSH 18%;
- Stoque fillimi: 95,000 euro; stoqe mbyllje: 150,000 euro;
- Pagat bruto: 150,000 euro; marketing: 35,000 euro; zhvlerësim tatimor i makinerisë: 30,000 euro; amortizim tatimor i K&Zh: 10,000 euro; donacion: 12,000 euro.

1. TVSH e llogaritur për shitjet është:

- a) 77,400 euro
- b) 87,400 euro**
- c) 96,600 euro
- d) 111,600 euro

2. TVSH në import është:

- a) 39,600 euro
- b) 43,200 euro**
- c) 36,000 euro
- d) 46,800 euro

3. TVSH e zbritshme gjithsej është më afër:

- a) 124,200 euro
- b) 134,136 euro**
- c) 141,000 euro
- d) 91,980 euro

4. Kosto e mallrave të shitura është:

- a) 465,000 euro
- b) 485,000 euro**
- c) 505,000 euro
- d) 420,000 euro

5. TAK për vitin është më afër:

- a) 5,250 euro
- b) 6,750 euro**
- c) 7,950 euro
- d) 9,000 euro

Rasti 3: Dardania Residence Sh.A. - ndërtim afatgjatë dhe TVSH në patundshmëri (10 pikë)

Dardania Residence Sh.A. zhvillon apartamente rezidenciale. Projekti zgjat tre vite. Vlerat janë pa TVSH. Për qëllime të rastit, apartamentet rezidenciale trajtohen si furnizim i përjashtuar pa TVSH, ndërsa lokalet afariste si furnizim i tatueshëm me 18%. Koeficienti i zbritjes është 80%.

- Vlera e kontraktuar e apartamenteve: 4,800,000 euro; pagesa avans gjatë vitit: 35%;
- Kosto e ndërtimit e kryer gjatë vitit: 1,200,000 euro; kosto totale e parashikuar e ndërtimit: 3,000,000 euro;
- Toka e dedikuar për projektin: 600,000 euro;
- Shërbime arkitekturore nga Itali: 90,000 euro;
- Interes i kapitalizuar për financimin e projektit: 60,000 euro;
- Shitje e lokalve afariste gjatë vitit: 240,000 euro (në tërësi shuma e paguar); kosto e lidhur me lokalet afariste : 110,000 euro;
- TVSH në koston vendore të ndërtimit: 216,000 euro.

1. TVSH e llogaritur mbi avanset e apartamenteve rezidenciale është:

- a) 302,400 euro
- b) 0 euro**
- c) 864,000 euro
- d) 151,200 euro

2. TVSH e llogaritur për shitjen e lokalit afarist është:

- a) 0 euro
- b) 19,200 euro
- c) 43,200 euro**
- d) 36,000 euro

3. TVSH e zbritshme për koston vendore të ndërtimit është:

- a) 216,000 euro
- b) 172,800 euro**
- c) 108,000 euro
- d) 0 euro

4. TVSH e zbritshme me ngarkesë të kundërt për shërbimin arkitekturor është:

- a) 16,200 euro
- b) 14,400 euro
- c) 12,960 euro**
- d) 0 euro

5. Fitimi i tatueshëm i projektit për vitin është më afër:

- a) 220,000 euro
- b) 330,000 euro
- c) 470,000 euro
- d) 760,000 euro**

Pjesa C - Pyetje me përgjigje të zhvilluara (40 pikë)

Problemi 1 - TVSH, KMSH dhe rregullime tatimore të kombinuara (10 pikë)

PrishtinaEquip L.L.C. tregton pajisje teknologjike, kryen import dhe ofron shërbime mirëmbajtjeje. Vlerat janë pa TVSH, përveç rasteve kur theksohet ndryshe.

Nr.	Përshkrimi	Vlera (€)	Vërejtje
1	Shitje pajisje teknologjike - treg vendor	1,050,000	18%
2	Eksport mallrash	280,000	0%, me dokumentacion eksporti
3	Shitje produkte me normë të reduktuar	220,000	8%
4	Shërbime mirëmbajtjeje vendore	118,000	çmimi me TVSH 18%
5	Import pajisjesh	620,000	CIF; doganë 31,000
6	Blerje vendore aksesorë	236,000	çmimi me TVSH 18%
7	Qira depoje	60,000	pa TVSH, 18%
8	Konsulencë nga jo-rezident	45,000	ngarkesë e kundërt + WHT
9	Marketing	35,400	çmimi me TVSH 18%
10	Blerje veture menaxhmenti	47,200	me TVSH 18%, përdorim biznesor 55%
11	Stoqe fillimi	180,000	01.01.2026
12	Stoqe mbyllje	240,000	31.12.2026
13	Paga bruto	210,000	kontributi i punëdhënësit 5% shtesë
14	Zhvlerësim kontabël	85,000	zhvlerësim tatimor i lejuar 72,000
15	Donacion OJQ e licencuar	30,000	i paguar me bankë
16	Sponsorizim sportiv	18,000	përdoret si kredi tatimore sipas kufirit ligjor
17	Tërheqje personale e pronarit	50,000	e regjistruar gabimisht si shpenzim
18	Të ardhura interesi nga banka	9,000	jashtë TVSH-së

Kërkesat:

- Llogaritni të ardhurat neto nga shitjet dhe TVSH-në e llogaritur, duke përfshirë ngarkesën e kundërt.
- Llogaritni TVSH-në e zbritshme dhe TVSH-në për pagesë.
- Llogaritni Koston e Mallrave të Shitura (KMSH).
- Përgatitni llogaritjen e fitimit të tatueshëm dhe TAK për pagesë pas kreditit të sponsorizimit.

Zgjidhje

a)

Të ardhurat neto nga shitja

Shitje pajisje teknologjike	1,050,000
Eksport mallrash	280,000
Shitje produkte me normë të reduktuar	220,000
Shërbime mirëmbajtjeje vendore	118,000/1.18
Total	1,650,000

TVSH në shitje

Shitje pajisje teknologjike	1,050,000*18%	189,000
Shitje produkte me normë të reduktuar	220,000*8%	17,600
Shërbime mirëmbajtjeje vendore	118,000/1.18* 18%	18,000
Ngarkesa e kundërt	45,000*18%	8,100
Total TVSH e llogaritur		232,700

b)

TVSH në blerje

TVSH import	(620,000 + 31,000)*18%	117,180
TVSH blerje vendore	236,000/1.18*18%	36,000
TVSH qira depoje	60,000*18%	10,800
TVSH marketing	35,400/1.18*18%	5,400
TVSH e zbritshme ngarkesa e kundërt	45,000*18%	8,100
TVSH veturë	Lejohet deri 50% - 40,000*18%*50%	3,600
Total TVSH e zbritshme		181,080
TVSH për pagesë	232,700 - 177,480	51,620

c)

KMSH

Stoqet në fillim	180,000
Import pajisjesh (620,000+31,000)	651,000
Blerje vendore 236,000/1.18	200,000
Stoqet në fund	(240,000)
Total	791,000

d)

Përshkrimi	Shuma (€)	Vërejtje
Të ardhura nga shitjet	1,650,000	
Të ardhura interesi	9,000	
Të ardhura gjithsej	1,659,000	
KMSH	(791,000)	
Qira depoje	(60,000)	
Konsulencë jo-rezident	(45,000)	
Marketing	(30,000)	vlera neto
Paga + kontribut punëdhënësi	(220,500)	210,000 + 10,500
Zhvlerësim tatimor	(72,000)	zëvendëson zhvlerësimin kontabël
Fitim para donacionit	440,500	
Donacion i lejuar	(30,000)	nën kufirin 10%
Fitim i tatueshëm para kredisë	410,500	
TAK 10%	41,050	
Kredi sponsorizimi	(12,315)	max(30% x 41,050)
TAK për pagesë	28,735	

Problemi 2 - Lista e pagave, TAP (10 pikë)

DataWave Audit & Tax L.L.C. përgatit listën e pagave për muajin qershor 2026. Zbatoni kontributet pensionale 5% punëmarrës + 5% punëdhënës. Paga që tatohet është paga bruto pas zbritjes së kontributit pensional të punëmarrësit.

Nr.	Punonjësi	Paga bruto (€)	Koment
1	Arian K. - Drejtor Ekzekutiv	3,200	përfshin bonus 500
2	Besa M. - Drejtore Financiare	2,150	
3	Driton S. - Kontabilist Senior	1,400	përfshin orë shtesë 150
4	Elira P. - Zyrtare Tatimore	1,050	
5	Faton G. - Menaxher Shitjesh	850	përfshin provizion 100
6	Gresa L. - Asistente Administrative	520	
7	Ilir R. - Praktikant	425	

Kërkesat:

- Verifikoni nëse pagat bruto janë në përputhje me pagën minimale.
- Llogaritni kontributin pensional të punëmarrësit dhe të punëdhënësit.
- Llogaritni bazën e TAP-it dhe TAP-in mujor sipas shkallëve aktuale.
- Llogaritni pagën neto dhe koston totale të punëdhënësit për secilin punonjës dhe totalin e muajit.

Zgjidhje

Të gjitha pagat bruto janë në përputhje me pagën minimale 425 euro para dates 1 Korikk 2026

Kontributet pensionale janë 5% punëmarrës dhe 5% punëdhënës.

Punonjësi	Bruto	Kontr. punëmarrës 5%	Baza TAP	TAP	Neto	Kontr. punëdhënës	Kosto punëdhënësi
Arian K.	3,200.00	160.00	3,040.00	275.00	2,765.00	160.00	3,360.00
Besa M.	2,150.00	107.50	2,042.50	175.25	1,867.25	107.50	2,257.50
Driton S.	1,400.00	70.00	1,330.00	104.00	1,226.00	70.00	1,470.00
Elira P.	1,050.00	52.50	997.50	70.75	926.75	52.50	1,102.50
Faton G.	850.00	42.50	807.50	51.75	755.75	42.50	892.50
Gresa L.	520.00	26.00	494.00	20.40	473.60	26.00	546.00
Illir R.	425.00	21.25	403.75	12.30	391.45	21.25	446.25
Totali	9,595.00	479.75	9,115.25	709.45	8,405.80	479.75	10,074.75

Problemi 3 - TAK i avancuar: shpenzime të kufizuara dhe rregullime tatimore (5pikë)

FinCore Manufacturing L.L.C. për vitin 2026 ka përgatitur pasqyrën e të ardhurave. Të gjitha vlerat janë pa TVSH. Kompania tatohet në bazë reale dhe ka dokumentacion për shpenzimet, përveç kur në rast thuhet ndryshe.

Nr.	Përshkrimi	Vlera (€)	Trajtimi / Vërejtje
1	Të ardhura nga shitjet	3,200,000	përfshihen në të ardhurat bruto
2	Të ardhura nga interesi bankar	12,000	përfshihet në TAK;
3	KMSH dhe shpenzime operative të zakonshme	2,030,000	pa zërat e paraqitur më poshtë
4	Paga bruto	420,000	
5	Kontributi i punëdhënësit 5%	21,000	
6	Shpenzime përfaqësimi/pritje	48,000	
7	Reklamë dhe promocion në media	65,000	
8	Donacion për OJQ me status përfitues publik	60,000	
9	Sponsorizim sportiv i vërtetuar	70,000	
10	Gjoha nga autoritet publik dhe interes ndëshkues	14,000	
11	Tatimi në të ardhura i vitit paraprak dhe kamata për vonesë	9,000	
12	Borxh i keq - plotëson kushtet ligjore	35,000	
13	Borxh i keq ndaj palës së lidhur, pa procedura	18,000	
14	Qira banese për akomodim të menaxherit rezident	24,000	
15	Trajnim profesional i stafit	22,000	
16	Riparime që zgjasin jetën e asetit > 1 vit	45,000	janë regjistruar si shpenzim; zhvlerësimi tatimor i vitit 5,000
17	Zhvlerësim kontabël i PPE	155,000	
18	Zhvlerësim tatimor i lejuar	128,000	
19	Tërheqje personale/dividend i pronarit i regjistruar si shpenzim	40,000	shpenzim i palejueshëm
20	Zbritje speciale për aset të ri prodhues	12,000	aset i ri dhe i vënë në përdorim
21	Humbje tatimore e bartur	90,000	brenda afatit dhe e dokumentuar
22	Parapagime të TAK gjatë vitit	12,000	zbriten nga obligimi final

Kërkesat:

- Përcaktoni fitimin kontabël para tatimit duke u bazuar në të dhënat e rastit.
- Përgatitni rregullimin nga fitimi kontabël në fitimin e tatueshëm, duke identifikuar shpenzimet e palejueshme dhe shpenzimet e kufizuara.
- Llogaritni kufirin e shpenzimeve të përfaqësimit dhe kufirin e donacionit.
- Llogaritni TAK 1, kreditin e sponsorizimit, parapagimet dhe obligimin final për pagesë.

Zgjidhje

Përshkrimi	Shuma (€)	Vërejtje
Fitimi kontabël para tatimit	136,000.00	Të ardhurat 3,212,000 - shpenzimet e regjistruara 3,076,000
Shto: teprica e shpenzimeve të përfaqësimit	15,880.00	48,000 - $1\% \times 3,212,000$
Shto: donacioni i regjistruar në libra	60,000.00	shtohet për të llogaritur kufirin 10%
Shto: sponsorizimi sportiv	70,000.00	trajtohet si kredi tatimore në këtë detyrë
Shto: gjobat/interesi ndëshkues	14,000.00	i palejueshëm
Shto: TAK i vitit paraprak dhe kamata	9,000.00	i palejueshëm
Shto: borxhi i keq ndaj palës së lidhur	18,000.00	i palejueshëm
Shto: qira banese për menaxher	24,000.00	i palejueshëm
Shto: riparimi i kapitalizueshëm, neto	40,000.00	45,000 shpenzim - 5,000 zhvlerësim i lejuar
Shto: diferenca e zhvlerësimit	27,000.00	155,000 kontabël - 128,000 tatimor
Shto: tërheqje personale/dividend	40,000.00	i palejueshëm
Zbrit: zbritje speciale për aset të ri	(12,000.00)	$10\% \times 120,000$
Baza para donacionit dhe humbjes	441,880.00	
Donacion i lejuar	(44,188.00)	(60,000; $10\% \times 441,880$)
Fitimi i tatueshëm para humbjes	397,692.00	
Zbrit: humbja tatimore e bartur	(90,000.00)	brenda afatit
Fitimi i tatueshëm	307,692.00	
TAK 10%	30,769.20	
Kredi sponsorizimi sportive	(9,230.76)	(70,000; $30\% \times 30,769.20$)
TAK pas kreditit	21,538.44	
Parapagime gjatë vitit	(12,000.00)	
TAK për pagesë	9,538.44	

Shpenzimi i përfaqësimit i lejuar është 32,120 euro ($1\% \times 3,212,000$), prandaj teprica e palejueshme është 15,880 euro.

Donacioni i lejuar është 44,188 euro, ndërsa pjesa e palejuar është 15,812 euro.

Kredi e sponsorizimit është 9,230.76 euro, sepse kufizohet në 30% të TAK-së para kreditit.

Problemi 4 - TVSH e avancuar: furnizime të përziera, avanse, import dhe ngarkesë e kundërt (10 pikë)

BesaMed Trade L.L.C. për muajin shtator 2026 ka këto transaksione. Vlerat janë pa TVSH, përveç rasteve kur theksohet "me TVSH". Koeficienti i zbritjes për shpenzimet e përziera është 90%. Krediti i bartur nga periudha paraprake është 5,000 euro.

Nr.	Përshkrimi	Vlera (€)	Vërejtje
1	Shitje pajisje medicinale - treg vendor	180,000	TVSH 8%
2	Shitje produkte farmaceutike me normë të reduktuar	120,000	TVSH 8%
3	Eksport mallrash me dokumentacion doganor	70,000	0%, me të drejtë zbritjeje
4	Shërbime shëndetësore të përjashtuara	30,000	Pa TVSH dhe pa të drejtë zbritjeje
5	Avans i pranuar për furnizim vendor me normë standarde	40,000	TVSH lind në momentin e pranimi të avansit
6	Blerje mallrash vendore për furnizime të tatueshme	94,400	Çmimi me TVSH 18%
7	Blerje mallrash për furnizime me normë të reduktuar	54,000	Çmimi me TVSH 8%
8	Import mallrash: CIF 50,000; doganë 5,000; akcizë 0	55,000	Bazë për TVSH në import
9	Shërbim konsulence nga Austria	20,000	Ngarkesë e kundërt; shpenzim i përzier
10	Shpenzime administrative të përziera	23,600	Çmimi me TVSH 18%
11	Veturë për menaxhment	35,400	Çmimi me TVSH 18%; përdorim biznesor 55%
12	Kredit TVSH nga periudha paraprake	5,000	Zbritet nga TVSH për pagesë

Kërkesat:

1. Llogaritni TVSH-në e llogaritur/dalëse, duke përfshirë avansin dhe ngarkesën e kundërt.
2. Llogaritni TVSH-në e zbritshme, duke aplikuar koeficientin 90%.
3. Përcaktoni TVSH-në për pagesë ose kreditin për bartje.

Zgjidhje

Kërkesa	Llogaritja	Rezultati (€)
TVSH e llogaritur 8%	$180,000 \times 8\%$	14,400.00
TVSH dalëse 8%	$120,000 \times 8\%$	9,600.00
Eksport dhe shërbime të përjashtuara	$70,000 \times 0\%$; 30,000 pa TVSH	0.00
TVSH mbi avansin	$40,000 \times 18\%$	7,200.00
Ngarkesë e kundërt - TVSH dalëse	$20,000 \times 18\%$	3,600.00
TOTAL TVSH e llogaritur		34,800
TVSH e zbritshme - blerje 18%	$94,400 / 1.18 \times 18\%$	14,400.00
TVSH e zbritshme - blerje 8%	$54,000 / 1.08 \times 8\%$	4,000.00
TVSH në import	$(50,000 + 5,000) \times 18\%$	9,900.00
TVSH e zbritshme nga ngarkesa e kundërt	$3,600 \times 90\%$	3,240.00
TVSH e zbritshme - shpenzime të përziera	$(23,600 / 1.18 \times 18\%) \times 90\%$	3,240.00
TVSH e zbritshme për veturën	përdorim biznesor e pranuar 50%, $5,400/2 \times 90\%$	2,430.00
TVSH e zbritshme gjithsej		37,210.00
TVSH para kreditit	$34,800 - 37,210$	(2,410.00)
Kredit i bartur	5,000	(5,000.00)
TVSH për pagesë	-2,410- 5,000	(7,410.00)

Problemi 5 - Procedura tatimore numerike: pagesë e vonuar, interes, gjobë dhe përgjegjësi (5 pikë)

Iliria Services L.L.C. i ka dorëzuar deklaratat me vonese për muajin maj 2026, ndersa nuk i ka paguar detyrimet deri më 30.09.2026. Afati i pagesës ishte 20.06.2026 per TVSH ndersa 15.06.2026 per tatimet tjera.

Nr.	Detyrimi i papaguar	Shuma (€)	Vërejtje
1	TVSH për pagesë	15,000	Deklaruar, por e papaguar
2	TAP i mbajtur në paga	2,500	Tatimi është mbajtur nga punonjësit
3	Kontribut pensional i punëmarrësve i mbajtur	4,200	Kontribut i mbajtur nga paga bruto
4	Kontribut pensional i punëdhënësit	4,200	Detyrim i punëdhënësit
5	Tatimi në burim nga qiratë/shërbimet	3,000	I mbajtur në burim, por i papaguar

Kërkesat:

1. Llogaritni principalin e papaguar.
2. Llogaritni interesin dhe gjobën e pagesës së vonuar deri më 30.09.2026.
3. Llogaritni totalin për pagesë.

Zgjidhje

a) Principali i papaguar

TVSH për pagesë	15,000
TAP i mbajtur në paga	2,500
Kontribut pensional i punëmarrësve i mbajtur	4,200
Kontribut pensional i punëdhënësit	4,200
Tatimi në burim nga qiratë/shërbimet	3,000
Total	28,900

b) Interesi dhe gjoba e vonesës

Interesi i vonesës= $28,900 \times 0.65\% \times 4$ muaj = 751.40

Gjoba për vonesë në deklarim= 150×4 (TVSH; TAP; KP; TB) = 600.00

c)

Totali për pagesë= $28,900 + 751.40 + 600.00 = 30,251$.